



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.250, datë 23.07.2021

**PËR CAKTIMIN ME SHORT TË RELATORIT PËR FILLIMIN E PROCEDURËS  
SË NGRITJES NË DETYRË TË DREJTUESIT PËR KANDIDATIN QË KA  
KALUAR PROCESIN E VERIFIKIMIT**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në nenet 159 pika 2 germa “i”, 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “ç”, 190 të Ligjit nr. 115/2016, “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 52 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 19 pika 1 e Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm” miratuar me Vendimin nr.200, datë 23.09.2020 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë,

**V E N D O S I:**

1. Caktimin me short të relatorit për procedurën e ngritjes në detyrën e drejtuesit për kandidatin që ka kandiduar për vendin vakant të drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, si më poshtë:

- Pozicion vakant i Drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Mat, relator Z. Bujar Sheshi.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

KRYETAR  
GENT I BRAHIMI